



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Numri i lëndës: 2023:235007

Datë: 13.12.2024

Numri i dokumentit: 06594937

K.DH.SH.II.nr.1448/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkalles se Dytë, me gjyqtarin Ramush Bardiqi, ne çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Ministria e Punës Mirëqenies Sociale-TEIP, me seli në Prishtinë, Inspektorati i Punës në Gjilan, kundër debitorit “N.P.N. “GLD Construction” me seli në Prishtinë, me adresë rr.” Xhavit Mitrovica” me pronar Sh. G., me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm-Dega Civile, PPP.nr.174/2016 të datës 02.12.2017, me datën 12.12.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET si e bazuar ankesa e debitorit “N.P.N. “GLD Construction” me seli në Prishtinë, ndërsa ANULOHET aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm-Dega Civile, PPP.nr.174/2016 të datës 02.12.2017, dhe lënda i kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje, Gjykatës Komerciale, Dhoma e Shkallës se Parë.

A r s y e t i m

Gjykata e Shkallës së Parë, me aktvendimin e ankimuar PPP.nr.174/2016 të datës 02.12.2017, në dispozitiv të aktvendimit e ka hudhë poshtë si të palejueshëm prapësimin e debitorit “N.P.N. “GLD Construction” me seli në Prishtinë, kundër urdhrin përmbarimor P.nr.291/15 të datës 20.08.2015.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka paraqitur ankesë debitori, për shkak te shkeljes se dispozitave te procedurës përmbarimore, konstatimit te gabuar dhe jo te plotë te gjendjes faktike, dhe zbatimit te gabuar te se drejtës materiale, me propozim që gjykata e shkalles se dytë ta aprovoj ankesën si te bazuar.

Dhoma e Shkalles se Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (LPP), gjeti se:

-Ankesa e debitorit është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit për përmbarim të autorizuarit të kreditorit Trupi Ekzekutiv i Inspektoratit të Punës (T.E.I.P) në Prishtinë, Inspektorati i Punës në Gjilan, ka lëshuar urdhrin përmbarimor P.nr.291/15 të datës 20.08.2015, me të cilin ka lejuar përmbarimin e aktvendimit të Trupit Ekzekutiv të Inspektoratit të Punës Nr.34-02/b, të datës 11.06.2015, me të cilin është obliguar debitori që në emër të masës ndëshkimore të paguaj shumën prej 1,000.00€.

Debitori brenda ka paraqitur prapësim me datën 25.01.2016 me të cilin është kundërshtuar urdhëri përmbarimor, mirëpo prapësimi nuk përmban firmën e parashtruesit- pra nënshkrimin e debitorit.

Gjykata e Shkallës së Parë, pas vlerësimit të prapësimit ka nxjerrë aktvendimin PPP.nr.174/2016 të datës 02.12.2017, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar. Në arsyetim të aktvendimit Gjykata e Shkallës së Parë ka vlerësuar se prapësimi i parashtruar kundër urdhrin përmbarimor edhe pse përmban elementet tjera me dispozitën e nenit 69.6 të LPP-së nuk përmban nënshkrimin e debitorit.

Pikëpamjet juridike të gjykatës së shkallës së parë, kjo gjykatë nuk mund t'i pranon si të rregullta dhe të ligjshme, për arsye se aktvendimi i ankimuar është përfshirë me të meta thelbësore nga neni 182.1, të LPK-së.

Gjykata Komerciale –dhoma e shkallës së dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë nuk ka vendosur drejtë kur ka hudhur poshtë si të palejuar propozimin për përmbarim të kreditorit pasi që e njëjta nuk ka vepruar konform dispozitave ligjore të Ligjit për Procedurën Kontestimore konkretisht nenit 102 paragrafi 1, sipas të cilit është përcaktuar se: *“Kur një parashtrësë nuk arrin të jetë e kuptueshme dhe e plotë, siç kërkohet në paragrafin 2 të nenit 99, gjykata do ta thërrasë personin që e dërgon ta korrigjojë ose ta plotësojë parashtrësën. Në një rrethanë të tillë, gjykata e udhëzon palën për korrigjimet dhe për plotësimet që do të zënë vend dhe e cakton një periudhe treditore për korrigjimin dhe për plotësimin e parashtrësës. Ndërsa par.2 të këtij neni parashihet “ Në qoftë se parashtrësja e lidhur me afat korrigjohet, gjegjësisht plotësohet dhe i dorëzohet gjykatës brenda afatit të caktuar për një gjë të tillë, do të konsiderohet se i është parashtruar gjykatës në ditën kur është paraqitur për të parën herë”. Tutje par 3 i po këtij neni përcakton se “Do të konsiderohet se është tërhequr parashtrësja po që se nuk i kthehet gjykatës brenda afatit të caktuar, e në qoftë se i kthehet pa u korrigjuar, gjegjësisht pa u plotësuar, parashtrësja do të hidhet poshtë”.*

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë nuk i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbarimore kur e ka hedhur si jo të plotë prapësimin e debitorit për shaka të nënshkrimit të prapësimit, ngase sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës, gjykata e shkallës së parë nuk

i ka dërguar konkluzion me të cilin do ta urdhëronte të njëjtin që pas pranimit të konkluzionit, ta plotësoj prapësimin e datës 25.01.2016 dhe t'ia sjell gjykatës të nënshkruar nga debitori, e nëse parashtruesi i prapësimit nuk do të vepronte sipas udhëzimeve të gjykatës së shkallës së parë, e njëjta do të duhej të merrte vendim konform dispozitave ligjore të Ligjit per Proceduren Kontestimore.

Në ri procedurë, Gjykata e shkallës së parë duhet të veproj në kuptim të vërejtjeve të sipërpërmendura, të vërtetoj në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike, me konkluzion të kthej në plotësim prapësimin e debitorit e pas kësaj të vazhdojë procedurën konform dispozitave ligjore duke marrë aktvendim të drejtë dhe të ligjshëm.

Kompetenca e Dhomës se Shkalles se Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 208, nenit 209, par.1 pika d) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,
Dhoma e Shkalles se Dytë
K.DH.SH.II nr.1448/24 me datë 12.12.2024

Gjyqtari,
Ramush Bardiqi